



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Financave – Ministarstvo Finansije – Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosovo – Tax Administration of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria Kosovës / Vlada Kosovo / Government of Kosovo
Ministria e Financave dhe Transfereve/ Ministarstvo za Finansije i Transfere
Ministry of Finance and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosovo / Tax Administration of Kosovo

ARKIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Org. Jedin.
Org. unit: 70

Proj. garantue
Proj. guarantee: /

01 HYRËSE PRISHTINË/A

01.06.2025

23.07.26

**KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR APLIKIMIN, CERTIFIKIMIN
DHE MIRËMBAJTJEN E SOFTUERËVE ELEKTRONIKË FISKALË
(SEF)**

Me qëllim të zbatimit të nenit 35, paragrafi 5 të Udhëzimit Administrativ (MF) Nr. 01/2026 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, në mbështetje të nenit 49, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, si dhe nenit 23 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, miraton:

KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR APLIKIMIN, CERTIFIKIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E SOFTUERËVE ELEKTRONIKË FISKALË (SEF)

Neni 1 Qëllimi

Ky dokument përcakton kushtet dhe procedurat për aplikim, certifikim dhe mirëmbajtje të Softuerëve Elektronikë Fiskalë (SEF) nga personat fizikë dhe juridikë, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe me kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MF) Nr. 01/2026 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë.

Neni 2 Fushëveprimi

Ky dokument zbatohet për të gjithë personat fizikë dhe juridikë që aplikojnë për certifikim dhe mirëmbajtje të Softuerëve Elektronikë Fiskalë (SEF), në kuadër të zbatimit të sistemit të fiskalizimit të tatimpaguesve, në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MF) Nr. 01/2026 dhe specifikimet teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

Për qëllime të këtij dokumenti, termat si në vijim kanë kuptimin përkatës:

1. **Softueri Elektronik Fiskal (SEF)** – nënkupton softuerin elektronik të zhvilluar për regjistrimin dhe raportimin e automatizuar të transaksioneve financiare të tatimpaguesve, në përputhje me legjislacionin tatimor në Republikën e Kosovës. Përmes SEF-it regjistrohen furnizimet e mallrave dhe/ose shërbimeve për transaksionet me pakicë, gjenerohet kuponi fiskal dhe raportohen të dhënat në kohë reale në Sistemin Informativ të ATK-së.
2. **Kuponi fiskal** – nënkupton dokumentin në të cilin regjistrohet furnizimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në pikën e shitjes për konsumatorin final. Kuponi fiskal gjenerohet nga Pajisja Elektronike Fiskale/Sistemi Fiskal/Softueri Elektronik Fiskal (PEF/SF/SEF) dhe mund të shtypet në formë fizike ose të dërgohet në mënyrë elektronike për furnizime të veçanta. Karakteristikat e tij përfshijnë logon fiskale dhe nënshkrimin me kod QR.
3. **Person** – nënkupton personin fizik jo-afarist, personin fizik afarist dhe personin juridik të regjistruar si biznes, i cili ushtron veprimtari afariste në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. **Refuzim** – nënkupton vendimin e Komisionit për të mos miratuar kërkesën për certifikimin e Softuerit Elektronik Fiskal (SEF), pasi është konstatuar se aplikuesi nuk i përmbush kushtet, kriteret ose kërkesat teknike, funksionale apo ligjore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe këtë dokument.
5. **Tërheqje e certifikatës** – nënkupton masën administrative me të cilën Administrata Tatimore e Kosovës ia heq përkohësisht vlefshmërinë certifikatës së lëshuar për një Softuer Elektronik Fiskal (SEF), deri në eliminimin e shkaqeve që kanë çuar në marrjen e kësaj mase.
6. **Anulim i certifikatës** – nënkupton vendimin e Administratës Tatimore të Kosovës me të cilin shfuqizohet certifikata e lëshuar për një Softuer Elektronik Fiskal (SEF), duke i pushuar përfundimisht të gjitha të drejtat që burojnë nga certifikimi.
7. **Pezullim** – nënkupton ndërprerjen e përkohshme të procedurës së shqyrtimit të kërkesës ose të vlefshmërisë së certifikatës së SEF-it, deri në përmbushjen e kushteve, kërkesave ose detyrimeve të përcaktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 4 **Baza Ligjore**

1. Ligji Nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore, neni 3, paragrafët 1.29, 1.30 (nënparagrafët 1.30.1 dhe 1.30.2), si dhe paragrafi 1.33, citojmë:

“1.29. Person – personin fizik dhe juridik;

1.30. Person fizik:

1.30.1. personin fizik joafarist që nuk ka të regjistruar aktivitet biznesi; dhe

1.30.2. personin fizik afarist që ka të regjistruar biznes në bazë të legjislacionit në fuqi dhe që zhvillon aktivitet të rregullt biznesor;

1.33. Person juridik – një shoqëri ose një organizatë tjetër biznesi që ka statusin e një personi juridik sipas legjislacionit në fuqi për Shoqëritë tregtare dhe çdo legjislacion tjetër në fuqi në Republikën e Kosovës;”

2. Udhëzimi Administrativ (MF) Nr. 01/2026, datë 27.04.2026 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, neni 35, paragrafi 5, citojmë:

“5. Kushtet dhe procedurat e aplikimit për certifikim dhe mirëmbajtje të SEF-it, përcaktohen nga një Komision i veçantë nga ATK-ja.”

3. Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës Nr. 01-06-1670, datë 04.05.2026, për themelimin e Komisionit përgjegjës për përgatitjen e dokumentit për përcaktimin e kushteve dhe procedurave të aplikimit për certifikim dhe mirëmbajtje të Softuerëve Elektronikë Fiskalë (SEF).

Neni 5

Kushtet dhe procedurat e aplikimit për certifikim dhe mirëmbajtje të SEF-it

1. Në pajtim me nenin 35 të Udhëzimit Administrativ (MF) Nr. 01/2026 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë, përcaktohen detyrimet, procedurat dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së zhvilluesve dhe/ose mirëmbajtësve të SEF në territorin e Republikës së Kosovës.

2. Çdo person fizik apo juridik, përfshirë individët dhe subjektet afariste të regjistruara, që synon të zhvillojë ose mirëmbajë një Softuer Elektronik Fiskal, duhet të veprojë në përputhje me specifikat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK).

3. Para fillimit të ofrimit të këtyre shërbimeve për qëllime të fiskalizimit të tatimpaguesve, zhvilluesit dhe/ose mirëmbajtësit e SEF-it duhet të aplikojnë për regjistrim dhe certifikim të softuerit pranë Komisionit të themeluar në kuadër të ATK-së. Ky autorizim është parakusht për ushtrimin e ligjshëm të kësaj veprimtarie.

4. Aplikimi për certifikim dhe mirëmbajtje të SEF-it bëhet në mënyrë fizike, përmes dorëzimit të kërkesës në Zyrën Qendrore të ATK-së, apo në mënyrë elektronike së bashku me dokumentacionin përkatës, sipas kushteve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MF) Nr. 01/2026 për Shfrytëzimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, Sistemeve Fiskale dhe Softuerëve Elektronikë Fiskalë.

5. Çdo person fizik jo afarist, person fizik afarist apo person juridik që aplikon për certifikimin dhe mirëmbajtjen e një Softueri Elektronik Fiskal (SEF) pranë Administratës Tatimore të

Kosovës (ATK), duhet të dorëzojë kërkesën përkatëse së bashku me dokumentacionin si në vijim:

- 5.1. **Kërkesa për certifikim të SEF-it** – formulari standard i aplikimit (formulari në shtojcë të këtij dokumenti), i plotësuar dhe të nënshkruar me të gjitha të dhënat e nevojshme;
- 5.2. **Kur aplikuesi është person fizik jo-afarist**, kopjen e dokumentit identifikues personal, të vlefshëm, të lëshuar nga autoritetet kompetente, që vërteton statusin e aplikuesit si person rezident ose jo-rezident në Republikën e Kosovës;
- 5.3. **Kur aplikuesi është person fizik afarist apo person juridik**, kopjen e Certifikatës së Regjistrimit të Biznesit, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK);
- 5.4. **Kur aplikuesi është konsorcium**, kopjen e Certifikatës së Numrit Fiskal të lëshuar nga ATK;
- 5.5. **Përshkrimi i përgjithshëm i zgjidhjes softuerike**, përfshirë, funksionalitetet dhe mënyrën e integritetit (ndërlidhjes së SEF me sistemin e ATK-së), si dhe listën e teknologjive të përdorura në zhvillimin e softuerit (format i lirë);
- 5.6. **Manuali i përdoruesit dhe udhëzimet bazë për përdorim** (format i lirë);
- 5.7. **Nënshkrimin e deklaratës së pajtueshmërisë së softuerit**, ku konfirmohet që softueri është në përputhje me kërkesat ligjore fiskale dhe specifikat teknike dhe funksionale të përcaktuara nga ATK-ja;

6. Në rast se dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi nuk është i plotë ose kërkon sqarime shtesë, Komisioni për certifikim njofton aplikuesin me shkrim për plotësimin e dokumentacionit.

7. Aplikuesi obligohet që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh pune nga data e pranimi të njoftimit, të dorëzojë dokumentacionin shtesë ose sqarimet e kërkuara.

8. Nëse aplikuesi nuk e plotëson dokumentacionin brenda afatit të përcaktuar sipas paragrafit 7 të këtij neni, kërkesa konsiderohet e tërhequr.

9. Pavarësisht dokumentacionit të përcaktuar në këtë nen, Administrata Tatimore e Kosovës, ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë dokumente, informata, dëshmi, garanci ose kushte shtesë nga aplikuesi, kur një gjë e tillë vlerësohet e nevojshme për mbrojtjen e interesit publik, sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi, garantimin e integritetit dhe sigurisë së sistemit fiskal, si dhe për verifikimin e përmbushjes së kërkesave specifike, teknike dhe funksionale të përcaktuara nga ATK.

10. Në përputhje me paragrafin 9 të këtij, mosdorëzimi i dokumentacionit, informatave, dëshmimeve, garancive ose mosplotësimi i kushteve shtesë të kërkuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, brenda afatit të përcaktuar, mund të rezultojë me pezullimin e shqyrtimit të kërkesës ose refuzimin e saj. Ndërsa, në rastet kur aplikuesi është i certifikuar, mosplotësimi i kërkesave të përcaktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës, mund të rezultojë me pezullimin, tërheqjen ose anulimin e certifikatës.

Neni 6

Procedura e shqyrtimit dhe testimit teknik

1. Pas dorëzimit të dokumentacionit, Komisioni për certifikim shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur.
2. Gjatë fazës së testimit teknik, Komisioni vlerëson përputhshmërinë e softuerit me specifikimet teknike dhe funksionale, si: Nivelin e sigurisë dhe integritetit të të dhënave; Saktësinë e gjenerimit të kuponëve fiskalë; Raportimin korrekt dhe në kohë reale të të dhënave në sistemin e ATK-së; Ruajtjen dhe transmetimin automatik të transaksioneve pas rivendosjes së komunikimit, në rastet e ndërprerjes së komunikimit me sistemin informativ të ATK-së; si dhe Aspekte të tjera teknike dhe funksionale relevante për fiskalizim.
3. Në rast se gjatë procesit të testimit teknik identifikohen mangësi ose mospërputhje që nuk ndikojnë në mënyrë kritike në funksionalitetin fiskal të SEF-it, Komisioni mund t'i japë aplikuesit afat për korrigjimin e tyre.
4. Afati për korrigjimin e mangësive është shtatë (7) ditë pune nga data e njoftimit.
5. Pas përfundimit të korrigjimeve, aplikuesi obligohet të njoftojë Komisionin dhe të mundësojë ri-testimin e SEF-it.

Neni 7

Vendimmarrja lidhur me certifikimin e SEF-it

1. Komisioni për Certifikimin e SEF-it merr vendim për certifikim ose moscertifikim brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pune nga data e pranimit të kërkesës për certifikim të SEF-it.
2. Në rast të miratimit të kërkesës, aplikuesit i lëshohet certifikata përkatëse dhe softuerit i caktohet Numri Identifikues i SEF-it.
3. Certifikata mbetet e vlefshme deri në revokimin e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Për çdo ndryshim funksional apo teknik të SEF-it, që ndikon në mënyrën e gjenerimit, ruajtjes apo transmetimit të të dhënave fiskale duhet të njoftohet paraprakisht Administrata Tatimore e Kosovës.
5. Në rast të refuzimit të kërkesës për certifikim, aplikuesi njoftohet me shkrim për arsyet e refuzimit.
6. Aplikuesi ka të drejtë të riaplikojë për certifikimin e Softuerit Elektronik Fiskal (SEF) vetëm pas kalimit të afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data e pranimit të vendimit për refuzim, me kusht që të jenë eliminuar shkaqet që kanë çuar në refuzimin e kërkesës.
7. Administrata Tatimore e Kosovës mban regjistër zyrtar të Softuerëve Elektronikë Fiskalë (SEF) të certifikuar.

8. Regjistri përmban së paku:

- emrin e zhvilluesit dhe/ose mirëmbajtësit;
- emrin e SEF-it;
- numrin identifikues të SEF-it;
- datën e certifikimit;
- statusin e certifikatës.

9. Regjistri i SEF-ve të certifikuara publikohet në uebfaqen zyrtare të ATK-së.

Neni 8

Pezullimi, tërheqja dhe anulimi i certifikatës së SEF-it

1. Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë të verifikojë funksionimin e SEF-it pas instalimit të tij.

2. Komisioni për Certifikimin e SEF-it, sipas rrethanave të rastit, mund të vendosë pezullimin, tërheqjen ose anulimin e certifikatës kur:

2.1. përdoruesit ballafaqohen me probleme serioze lidhur me funksionimin e SEF-it;

2.2. zhvilluesi i SEF-it e ka shkelur ndonjë dispozitë të këtij apo ndonjë akti tjetër nënligjor, të lëshuar lidhur me SEF-in;

2.3. Ndryshojnë kushtet nga ATK mbi bazën e të cilave është lëshuar certifikata dhe ato nuk përputhen me zhvilluesin e SEF-it.

3. Kundër vendimit të Komisionit, pala ka të drejtë ankese sipas procedurave të përcaktuara nga Administrata Tatimore e Kosovës.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky dokument hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore.

Datë 03 / 07 /2026

Mentor Hyseni

Drejtor i Përgjithshëm i ATK-së